

Udhëzimi nr. 25, datë 02.08.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve", i ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 04.10.2019

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma a (e # me 22/I/1/a)	Qeveria e nxënësve ka organizuar veprimtari, nëpërmjet të cilave u është dhënë mundësia nxënësve të dëgjohen nga drejtuesit dhe mësuesit e shkollës, për idetë në të mirë të tyre dhe të shkollës.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma b (e # me 22/I/1/b)	Qeveria e nxënësve ka organizuar veprimtari të nxënësve në dobi të shkollës.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma c (e # me 22/I/1/c)	Qeveria e nxënësve ka organizuar veprimtari që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset vendimmarrëse.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma d (e # me 22/I/1/d)	Qeveria e nxënësve ka organizuar veprimtari që edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma e (e # me 22/I/1/e)	Qeveria e nxënësve ka kontribuar në krijimin e një klime pozitive në shkollë, veçanërisht në zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës, nxënës-mësues.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma f (e # me 22/I/1/f)	Qeveria e nxënësve ka kontribuar në parandalimin dhe pakësimin e abuzimit të nxënësve me duhanin, alkoolin, drogat, bullizmin, si dhe të braktisjes së shkollës.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma g (e # me 22/I/1/g)	Qeveria e nxënësve ka kontribuar në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma h (e # me 22/I/1/h)	Qeveria e nxënësve ka aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshen grupmoshat e tyre.		
Kreu 1, Nënkreu IV, Gërma i (e # me 22/I/1/i)	Qeveria e nxënësve ka zgjedhur një herë në dy vjet, nxënësit e shkollës që do të kandidojnë për Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë, nga kuotat e përcaktuara për kategoritë e veçanta të nxënësve		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 1	Shkolla ka ngritur qeverinë e nxënësve në bazë shkolle.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 2	Shkolla ka organizuar zgjedhjet për qeverinë e nxënësve në fillim të çdo viti mësimor.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 3	Në shkollën e arsimit bazë, përfaqësohen në qeverinë e nxënësve klasat 6 - 9.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 4	Në shkollat vetëm fillore, përfaqësohen në qeverinë e nxënësve klasat 4 - 6.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 5, Gërma a	Kur një klasë ka një deri në katër paralele, nxënësit, nën kujdesin e mësuesve kujdestarë përkatës, kanë zgjedhur për çdo klasë paralele nga një anëtar të qeverisë së nxënësve.		

Kreu 2, Nënkreu I, Pika 5, Gërma b	Kur një klasë ka më shumë se katër paralele, çdo klasë paralele, nën kujdesin e mësuesit kujdestar përkatës, ka zgjedhur me shumicë votash tre nxënës, të cilët formojnë së bashku përfaqësuesit e paraleleve të një klase. Përfaqësuesit e paraleleve të një klase, nën kujdesin e një mësuesi të caktuar, kanë zgjedhur me shumicë të thjeshtë votash të fshehta, katër anëtarë të qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 6	Në shkollën e arsimit bazë dhe në shkollën fillore, kur është më vete, kryetari i qeverisë së nxënësve është zgjedhur një anëtar i qeverisë, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të saj, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 7	Në arsimin e mesëm të lartë, kryetari i qeverisë së nxënësve është zgjedhur një nga anëtarët e qeverisë, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të nxënësve të shkollës, me konkurrimin e më shumë se një kandidati për rolin e kryetarit.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 8	Kryetari i qeverisë së nxënësve nuk ka lidhje familjare me drejtorin e shkollës.		
Kreu 2, Nënkreu I, Pika 9 (e # me 22/I/2)	Kryetari i qeverisë së nxënësve, për të fituar të drejtën të kandidojë në zgjedhjet e Parlamentit të Nxënësve të Shqipërisë, është përzgjedhur nga klasat 4-8 për arsimin bazë dhe klasat 10-11 për arsimin e mesëm të lartë.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 1 (e # me 22/I/3/1)	Qeveria e nxënësve ka kryetarin dhe sekretarin e saj.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 2 (e # me 22/I/3/2)	Qeveria e nxënësve është e përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga nxënësit në bazë klase apo klasash paralele, sipas procedurave të parashikuara në nënkreun I, të kreut 2, të udhëzimit 22.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma a (e # me 22/I/3/3/a)	Kryetari i qeverisë së nxënësve ka drejtuar veprimtarinë e qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma b (e # me 22/I/3/3/b)	Kryetari i qeverisë së nxënësve ka drejtuar ndarjen e detyrave midis anëtarëve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma c (e # me 22/I/3/3/c)	Kryetari i qeverisë së nxënësve ka drejtuar hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma d (e # me 22/I/3/3/d)	Kryetari i qeverisë së nxënësve ka përfaqësuar nxënësit në bordin e shkollës.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma e (e # me 22/I/3/3/e)	Kryetari i qeverisë së nxënësve ka përfaqësuar nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda e jashtë saj.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 3, Gërma f (e # me 22/I/3/3/f)	Kryetari i qeverisë së nxënësve është shkarkuar nga detyra, prej drejtorit të shkollës, për thyerje të rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi.		

Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 4, Gërma a (e # me 22/I/3/4/a)	Sekretari i qeverisë së nxënësve është zgjedhur me shumicë votash, në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 4, Gërma b (e # me 22/I/3/4/b)	Sekretari i qeverisë së nxënësve ka përgatitur materialet për mbledhjet e qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 4, Gërma c (e # me 22/I/3/4/c)	Sekretari i qeverisë së nxënësve ka mbajtur shënime në mbledhjet e qeverisë së nxënësve		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 4, Gërma d (e # me 22/I/3/4/d)	Sekretari i qeverisë së nxënësve ka lajmëruar anëtarët dhe të ftuarit për mbledhjen e qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 4, Gërma e (e # me 22/I/3/4/e)	Sekretari i qeverisë së nxënësve ka mbajtur arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 5, Gërma a (e # me 22/I/3/5/a)	Anëtari i qeverisë së nxënësve ka komunikuar mendimet e nxënësve që përfaqëson.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 5, Gërma b (e # me 22/I/3/5/b)	Anëtari i qeverisë së nxënësve ka përcjellë vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 5, Gërma c (e # me 22/I/3/5/c)	Anëtari i qeverisë së nxënësve ka propozuar masa ose veprimtari që mund të organizohen në nivel shkolle.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 5, Gërma d (e # me 22/I/3/5/d)	Anëtari i qeverisë së nxënësve ka marrë pjesë dhe ka qenë aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu I/1, Pika 5, Gërma e (e # me 22/I/3/5/e)	Anëtari i qeverisë së nxënësve ka raportuar në çdo mbledhje te kryetari i qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 1	Qeveria e nxënësve funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloren e brendshme të shkollës dhe rregulloren e saj.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 2	Rregullorja e qeverisë së nxënësve është hartuar nga grupe pune me nxënës dhe është miratuar nga qeveria e saj, pasi është marrë pëlqimi nga bordi dhe drejtori i shkollës.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 3	Qeveria e nxënësve ka zgjedhur në mbledhjen e saj të parë nënkryetarin dhe sekretarin.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 4	Anëtarët e qeverisë së nxënësve kanë kryer detyra që mbulojnë aspekte të veçanta të veprimtarisë së shkollës, si dhe klasa të caktuara, veçanërisht të fillores për qeverinë e nxënësve të arsimit bazë.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 5	Qeveria e nxënësve ka informuar rregullisht nxënësit për veprimtarinë e saj.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 6, Gërma a	Qeveria e nxënësve ka hartuar dhe ka zbatuar planin e saj vjetor në bashkëpunim me nxënës të shkollës.		

Kreu 2, Nënkreu II, Pika 6, Gërma b	Qeveria e nxënësve ka përgatitur raportin vjetor të veprimtarisë së saj, të cilin ia ka dërguar drejtorisë, kryetarit të bordit dhe kryetarit të këshillit të prindërve, si dhe ka mundësuar leximin e këtij raporti nga nxënësit e shkollës.		
Kreu 2, Nënkreu II, Pika 7	Qeveria e nxënësve ka ftuar në mbledhjet e saj, përfaqësues të klasave të fillores për qeverinë e nxënësve të arsimit bazë, nga bordi i shkollës, drejtorja, këshilli i prindërve të shkollës, mësues, përfaqësues të OJF-ve.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 1 (e # me 22/I/4/1)	Qeveria e nxënësve ka marrë nisma për veprimtari jashtëkurrikulare, jopolitike, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 2 (e # me 22/I/4/2)	Qeveria e nxënësve ka përgatitur dhe ka realizuar projekte, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, për plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 3 (e # me 22/I/4/3)	Qeveria e nxënësve ka përgatitur dhe ka realizuar projekte, pas miratimit nga drejtori i shkollës, me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsim.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 4 (e # me 22/I/4/4)	Qeveria e nxënësve ka zhvilluar pyetësorë mbi kënaqësitë e nxënësve për shërbimin që shkolla siguron ose për aspekte të veçanta të jetës shkollore të nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 5 (e # me 22/I/4/5)	Qeveria e nxënësve ka bashkëpunuar me strukturat homologe të shkollave të tjera, brenda e jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 6 (e # me 22/I/4/6)	Qeveria e nxënësve ka komunikuar vazhdimisht për veprimtarinë e saj me këshillin e prindërve.		
Kreu 2, Nënkreu III, Pika 7 (e # me 22/I/4/7)	Qeveria e nxënësve ka hartuar planin vjetor, mbi bazën e përparësive të identifikuara nga të gjitha klasat e shkollës, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.		
Kreu 2, Nënkreu IV, Pika 1, Gërma a	Qeveria e nxënësve ka përzgjedhur mësuesin ndihmës, i cili e ndihmon në hartimin dhe zbatimin e veprimtarive të qeverisë së nxënësve dhe, në veçanti, në hartimin e rregullores së qeverisë së nxënësve.		
Kreu 2, Nënkreu IV, Pika 1, Gërma b	Qeveria e nxënësve ka kërkuar zëvendësimin e mësuesit ndihmës të saj, kur ai nuk ka kryer detyrat e tij.		
Kreu 2, Nënkreu IV, Pika 2	Drejtori i shkollës ka emëruar mësuesin ndihmës.		
Kreu 2, Nënkreu IV, Pika 3	Mësuesit ndihmës nuk i është dhënë klasë në kujdestari, me përjashtim të rasteve kur në shkollë ekzistojnë klasa pa mësues kujdestarë.		
Kreu 3, Nënkreu I, Gërma a	Drejtori i shkollës ka vënë në dispozicion të qeverisë së nxënësve dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e saj dhe të shkollës, si ligji për sistemin arsimor parauniversitar dhe akte të tjera nënligjore.		

Kreu 3, Nënkreu I, Gërma b	Drejtori i shkollës ka takuar një herë në dy muaj qeverinë e nxënësve për të dëgjuar shqetësimet dhe propozimet e saj.		
Kreu 3, Nënkreu I, Gërma c	Drejtori i shkollës i ka siguruar qeverisë së nxënësve një mjedis ku të zhvillojë veprimtaritë e saj, të ruajë arkivin e saj, si dhe një vend ku të afishojë lajmërimet.		
Kreu 3, Nënkreu I, Gërma d	Drejtori i shkollës ka përfshirë përfaqësues të qeverisë së nxënësve në grupet e punës që hartojnë rregulloren e shkollës, planin afatmesëm dhe planin e saj vjetor.		
Kreu 3, Nënkreu I, Gërma e	Drejtori i shkollës ka ftuar kryetarin e qeverisë së nxënësve në mbledhje të këshillit të mësuesve, kur shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me kontributin e qeverisë së nxënësve.		
Kreu 3, Nënkreu II	Kryetari i qeverisë së nxënësve i ka kërkuar leje me shkrim drejtorit të shkollës për veprimtari jashtëkurrikulare të qeverisë së nxënësve, të cilat i organizon në mjediset e shkollës ose jashtë saj.		